



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 180, Datë 20.08.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALESIO – 2014” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “FUSHË ARRËZ” ME FUQI  
TË INSTALUAR 1990 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.08.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “ALESIO – 2014” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 143, datë 25.06.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ALESIO – 2014” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Fushë – Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kW.
- ERE me shkresën nr. 55/38 Prot., datë 26.06.2018, ka bërë njoftimin në media për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit.
- ERE me shkresën nr. 420/1 Prot., datë 28.06.2018, i ka kërkuar subjektit plotësimin e dokumentacionit të munguar ose jo të plotë, që konsistonte në:
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2 gërma “d” të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” (rifreskimi i vërtetimit nga Prokuroria dhe Gjykata).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërma “a” të Rregullores sipërcituar, (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave). Neni 9, pika 3, gërma “c” të Rregullores sipërcituar, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).
- Dokumentacioni Teknik për HEC. Neni 9, pika 4.1.3, gërma “b” të Rregullores sipërcituar, (një diagramë elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes).
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 420/3 Prot., datë 07.08.2018, subjekti “ALESIO 2014”, ka përcjellë në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, nuk rezulton të ketë vërejtje apo ankesë nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALESIO – 2014” sh.p.k.
- Në përfundim të shqyrtimit, rezulton se aplikimi i shoqërisë “ALESIO – 2014” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”.
- Kontrata Nr. 986 Rep. dhe Nr. 431/2 Kol., datë 09.05.2018, e lidhur ndërmjet shoqërisë “Alesio – 2014 ” sh.p.k, në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë parashikon një kohëzgjatje prej 49 vjetësh. Neni 38, pika 1, germa “a” i Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, parashikon se afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet. Neni 5, pika 1, germa “a” i “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, parashikon se kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës për prodhimin e energjisë elektrike është deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ALESIO – 2014” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “FUSHË ARRËZ” me fuqi të instaluar 1990 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**